



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:004584
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05849030

C-IV-14-6860

A S Fshati S e J, Viti.

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH N.B.I “Agromorava”, në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtares Ganimete Puka, me 24.qershor. 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI035-0274 datë 01 tetor 2014.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 31 tetor 2014, pranë DHPGJS, ankuesi parashtroj një kërkesë për rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) GJI035-0274 datë 01 tetor 2014 (tani e tutje Vendimi), me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës, në shumë prej 600.00 (gjashtë zero zero) Euro, ndaj NSH N.B.I “Agromorava”, (në likuidim). Ankuesi pohoi se në NSH në fjalë ka qenë e punësuar për kohë të pacaktuar dhe asnjëherë nuk ju është ndërpre marrëdhënia e punës nga AKP më letër pezullim për shkak të shitjeve të aseteve të NSH “Agromorava”, por vetëm se është njoftuar se i përfundon marrëdhënia e punës për shkak të tepricës dhe se ky përfundim i punës ka efekt të menjëhershëm. Ankuesi me kërkesën për rishikim pretendon në të drejtën në kompensim si rezultat i ndërprerjes së marrëdhënies së punës, e drejtë kjo e paraparë sipas Ligjit të punës në Kosovë. Ankuesi nga gjitha arsyet, përfundimisht kërkon që kërkesa e saj për rishikim të aprovohet dhe që ti njihet e drejta në kompensimin e pagave, në shumën e kërkuar.

Ankuesi me kërkesë ka bashkangjitur: kopjen e vendimit të kundërshtuar, kopje e Konfirmimit të policisë me nr. 128 të datës 20 prill 2011, kopje e gazetës Koha Ditore e datës 16 prill 2011

(informacion “Një zjarr dëmton zyrat e ish “Agromoravës”) dhe kopje e procesverbalit të datës datës 15 prill 2011.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 08 maj 2024 parashtrorj përgjigjen.

AKP kundërshtoj kërkesën për rishikim duke e konsideruar si të pabazuar. AKP konsideroj se AL ka bërë një vlerësim të saktë si të rrethanave faktike e po ashtu se dispozitat ligjore janë zbatuar në mënyrë të drejtë. AKP gjithashtu konsideron se kërkesa për rishikim nuk përmban argumentet e saj ligjore, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. Përfundimisht, sipas AKP, kërkesa kreditore e ankuesit është e pabazuar respektivisht konsiderohet e parashkruar, sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP lidhur me dispozitat ligjore të Ligjit mbi punën e bashkuar- LPB. Nga gjitha arsyet propozon që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e vendimit të AL-së.

Me datë 16 maj 2024, me urdhër ankuesit i është dërguar mbrojtja e AKP-së, i njëjti e ka pranuar dhe nuk është përgjigjur.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrësat e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesit, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij.

Më tutje, Sipas nenit 74 paragrafi 2, të Ligjit për DHPGJS, gjykata shqyrton kërkesat për rishikim të ankuesve të parashtruara kundër Vendimeve të AL.

Lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 parashihet:

- a. përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person, si dhe
- b. e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2

të Ligjit për AKP-në .

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbushja e kërkesave siç janë: “kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”.

Nga dispozitat e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar;
- b. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- c. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- d. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Ankuesi për më tepër nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 por edhe paragrafit 1.7 (kërkesat e pasiguruara) të po të njëjtit nen, si dhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Ankuesi ka theksuar se ka punuar në ndërmarrje NSH, Agromorava, pa ndërprere deri në fillimin e procedurës së likuidimit, ku edhe ka qitë kërkesës për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratë së punës, në anën tjetër nuk ka dorëzuar asnjë provë për ta provua këtë fakt të pohuar . Provat e dorëzuar si konfirmimi i Policisë , procesverbali nr.107, i dt.15.04.2021, se janë djegur zyra e ndërmarrje Agromorava, nuk mund të merr si provave për ti vërtetuar pretendimet e tij. E paditura nuk ka mohuar faktin se ankuesi ishte punëtor i ndërmarrjes në likuidimi. E paditura e ka kontestuar padinë duke theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës ngase parashtruesi i ankesës në lidhje me kompensimi për ndërprerjeje të kontratë së punës, të pretenduara nuk i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent tri vite nga qershorit 2008.

Në rastin konkret nga provat e shqyrtuara, gjykata ka konstatuar se parashtruesi i ankesës , nuk ka prezantuar prova që dëshmon se i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi kompetent në lidhje me borxhin e pretenduar pra nga viti 2008, që është koha e nevojshme për ndërprerje të parashkrim të kërkesës së pretenduar.

Me nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se “kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”. Rrjedhimisht në kuptim të dispozitës së lartë cekur gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesa e pretenduar e parashtrueses së ankesë për kompensim të pagave është e parashkruar.

Përfundimisht gjykata bazuar në rrethanat e lartë cekura dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Andaj gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Taksa Gjyqësore:

Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit është 1,000.00 €.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Ganimete Puka,

G j y q t a r e